VENDIM
Nr. 235, datë 2.11.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 196, DATË 30.8.2018, "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E BORDIT TË ERE-s, NR. 120, DATË 4.6.2018, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2018, TË SHOQËRISË 'ALBGAZ' SHA"' DHE NR. 121, DATË 4.6.2018, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT 10 -VJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHOQËRISË 'ALBGAZ' SHA"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 16, pika 12, të neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; të nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; të neneve 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", si dhe të nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për një ndryshim në vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, "Për një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s, nr. 120, datë 4.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë 'Albgaz' sh.a." dhe nr. 121, datë 4.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë 'Albgaz' sh.a.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, miratoi një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 120, datë 4.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë 'Albgaz' sh.a." dhe nr. 121, datë 4.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë 'Albgaz' sh.a.", duke shtyrë afatin e përcaktuar në këto vendime për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Sa më sipër, me shkresën nr. 495/2 prot., datë 3.9.2018, ERE ka përcjellë pranë "Albgaz" sh.a. njoftimin e vendimit nr. 196, datë 30.8.2018, të sipërcituar, duke i bërë me dije edhe detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të munguar, brenda datës 20.10.2018.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/4 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.1.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 196, datë 30.8.2018, si më poshtë:

- "Albgaz" sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 20.1.2019: miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018, që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot. datë 21.3.2018; argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 196, datë 30.8.2018, si më poshtë:

- "Albgaz" sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, jo më vonë se data 20.1.2019: miratim nga Këshilli Mbikëqyrës të Planit të Zhvillimit të Rrjetit për periudhën 1018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018; argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë "Albgaz" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti